

# GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl – Kzz – 26/2010

25 maj 2010

Prishtinë

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata Supreme e Kosovës**, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Emilio Gatti si Kryetar i kolegjit, me Gjyqtarin e EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger dhe Gjyqtarët e Gjykatës Supreme Avdi Dinaj, Emine Kaçiku dhe Emine Mustafa si anëtarë të kolegjit,

në procedurën penale kundër:

**N.G.**, me nofkën N., Shqiptar Kosovar, në paraburgim që nga data 4 korrik 2005, i akuzuar sipas Aktakuzës PP. Nr. 348-4/2005 të ndryshuar më 12 qershor 2006, për kryerje të dy veprave penale Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve (Pika 1 dhe nënpika (vii) e Pikës 3, siç përcaktohet me nenin 245, paragrafin 1 dhe 2 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i RSFJ-së) të zbatueshme sipas nenit 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24), të një veprave penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike (Pika 2 siç përcaktohet me nenin 229, paragrafin 1, 2, 3 dhe 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe të veprës penale Krim i organizuar (Pikat 1, 2 dhe nënpika (vii) e Pikës 3 siç përcaktohet me nenin 274 paragrafin 3 të KPK-së.

**H.G.**, Shqiptar Kosovar, në paraburgim që nga data 1 korrik 2005, i akuzuar sipas Aktakuzës PP. Nr. 348-4/2005 të ndryshuar më 12 qershor 2006, për kryerje të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike (Pika 2 siç përcaktohet me nenin 229, paragrafin 1, 2, 3 dhe 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe të veprës penale Krim i organizuar (Pika 2 dhe siç përcaktohet me nenin 274 paragrafin 2 të KPK-së.

Duke vendosur rreth kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtuar më 9 mars 2010 nga Prokurori i Shtetit të Kosovës në dëm të të pandehurve N.G. dhe H.G., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.-Kž. Nr. 394/2007, të datës 2 korrik 2009, i cili duke ndryshuar pjesërisht Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën P. Mr. 740/05, të datës 27 prill 2007 ka dënuar 1) N.G. për kryerje të dy veprave penale të Prodhimit dhe shitjes së paautorizuar të

narkotikëve, në kundërshtim me nenin 245, paragrafin 2 të Kodit Penal të RSFJ-së, të zbatuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/24 (Pika 1 dhe Pika 3, nënpika vii e Aktgjykimit), pastaj Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, në kundërshtim me nenin 229, paragrafin 3 KPK-së (Pika 2 e Aktgjykimit) dhe vepra penale e Krimit të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 3 të KPK-së dhe 2) H.G. për kryerje të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike (Pika 2 e Aktgjykimit) dhe të veprës penale Krim i organizuar në kundërshtim me nenin 274, par. 3 të KPK-së (Pikat 1, 2 dhe Pika 3, nënpika (vii) e Aktgjykimit).

Pas leximit të Plotësismit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të dorëzuar më 11 mars 2010 nga ana e Prokurorit të Shtetit, të përgjigjes së datës 17 mars 2010 të Avokatit mbrojtës Destan Rukiqi në emër të të pandehurit H.G. dhe të përgjigjes së datës 18 mars 2010 të Avokatit mbrojtës Naser Peci në emër të të pandehurit N.G., pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më datën 25 maj 2010,

Duke vepruar në përputhje me nenet 454 dhe 456-457 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshon këtë

## **AKTGJYKIM**

PRANOHET PJESËRISHT kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e parashtruar më 9 mars 2010 nga Prokurori i Shtetit të Kosovës, në dëm të të pandehurve N.G. dhe H.G. dhe konstatohet që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës i datës 27 prill 2007, P. Nr. 740/2005 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 2 korrik 2009, Ap.-Kz. Nr. 394/2007 shkelin nenet 6, 71 dhe 274, paragrafët (2) dhe (3) të KPK-së dhe nenin 391, par. 1, pikën 3 dhe 403, par. 2, pikën 1 të KPPK-së, për arsye se nuk është shqiptuar dënimi ligjor ndaj të pandehurve N.G., përkatësisht H.G. për veprat penale të Krimit të organizuar, siç përshkruhet në pikat 1, 2 dhe 3 (vii) të aktgjykimit për N.G. dhe në pikën 2 të aktgjykimit për H.G..

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar nga Prokurori i Shtetit të Kosovës REFUZOHET si e pabazë në pjesën tjetër.

# ARSYETIMI

## I

### Historia e Procedurës

1. Me Aktakuzën PP Nr. 348-4/2005 të paraqitur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 19 dhjetor 2005 Prokurori Ndërkombëtar akuzoi të pandehurit N.G. dhe H.G. për vepra penale Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve (në kundërshtim të nenit 245, paragrafit 1 dhe 2 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së), Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike (në kundërshtim të nenit 229, paragrafit 1, 2, 3 dhe 4 të KPPK-së lidhur me nenin 23 të KPPK-së, Krim i organizuar (në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 3 të KPPK-së dhe në kundërshtim të nenit 2.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/22) dhe Vrasje në tentativë (në kundërshtim të nenit 147 paragrafët 7 dhe 9 të KPPK-së).

Kjo aktakuzë ishte vërtetuar nga Gjyqtari për konfirmim të aktakuzës më 20 janar 2006. Më 13 qershor Prokurori Publik Ndërkombëtar paraqiti Aktakuzën e ndryshuar PP Nr. 348-4/2005 me të cilën ishin tërhequr akuzat për vrasje në tentativë kundër secilit të akuzuar; Aktakuza e ndryshuar ishte pranuar nga Gjykata e Qarkut.

2. N.G. është mbajtur në paraburgim mbi këto akuza që nga data 4 korrik 2005 dhe H.G. që nga data 1 korrik 2005 e deri më tani.

3. Shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë u mbajt mes datave 13 qershor 2006 dhe 27 prill 2007. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, pas një kërkesë për ndihmë ligjore ndërkombëtare të lëshuar nga Gjykata e Qarkut, ishin dëgjuar shtatë dëshmitarë në Gjermani mes datave 29 janar dhe 2 shkurt 2007.

4. Në Aktgjykimin P. Nr. 740/05, të datës 27 prill 2007 Gjykata e Qarkut shpalli N.G. fajtor si në vijim:

- **(Pika 1) Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve** - në kundërshtim të nenit 245 paragrafit 1 dhe 2 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së të kryer më datë apo rreth datës 24 janar 2004 dhe dënoi atë me shtatë vjet burgim;

- **(Pika 2) Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike** - në kundërshtim të nenit 229, paragrafit 1, 2, 3 dhe 4 të KPPK-së lidhur me nenin 23 të KPPK- të kryer më datë apo rreth datës 13 qershor 2004 dhe dënoi atë me pesë vjet burgim;

- **(Pika 3 nën pika i) Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve** në kundërshtim të nenit 245 paragrafit 1 dhe 2 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së të kryer në qershor 2003 dhe dënoi atë me tre vjet burgim;

- **(Pika 3 nën pika ii) Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve** në kundërshtim të nenit 245 paragrafit 1 dhe 2 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së të kryer në mes muajve qershor - korrik 2003 dhe dënoi atë me tre vjet burgim;

- **(Pika 3 nën pika iii) Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve** në kundërshtim të nenit 245 paragrafit 1 dhe 2 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së të kryer në mes muajve qershor - gusht 2003 dhe dënoi atë me tre vjet burgim;
- **(Pika 3 nën pika iv) Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve** në kundërshtim të nenit 245 paragrafit 1 dhe 2 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së të kryer në mes datës 9 dhe 15 shtator 2003 dhe dënoi atë me shtatë vjet burgim;
- **(Pika 3 nën pika v) Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve** në kundërshtim të nenit 245 paragrafit 1 dhe 2 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së të kryer në shtator 2003 dhe dënoi atë me pesë vjet burgim;
- **(Pika 3 nën pika vi) Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve** në kundërshtim të nenit 245 paragrafit 1 dhe 2 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së të kryer në shtator 2003 dhe dënoi atë me pesë vjet burgim;
- **(Pika 3 nën pika vii) Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve** në kundërshtim të nenit 245 paragrafit 1 dhe 2 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së të kryer në tetor 2003 dhe dënoi atë me pesë vjet burgim;

Gjykata e Shkallës së parë për të gjitha nën-pikat e Pikës 3 shqiptoi një dënim unik prej dymbëdhjetë vitesh burgim dhe përfundimisht për të gjitha Pikat një dënim unik prej pesëmbëdhjetë vitesh sipas nenit 71 paragrafit 1 dhe 2 të KPPK-së.

5. Në Aktgjykimin e lartpërmendur H.G. ishte shpallë fajtor për veprën penale **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike (Pika II)** kundërshtim të nenit 229, paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4 të KPPK-së lidhur me nenin 23 të KPPK-së të kryer më datë apo rreth datës 13 qershor 2004 dhe ishte dënuar me pesë vjet burgim.

6. Gjykata e Qarkut shfajësoi N.G. nga kryerja e tri veprave, të përshkruara në Aktakuzën e ndryshuar në Pikën 3 nën a), b) dhe c), të veprës penale Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve siç përcaktohet me nenin 245 paragrafët 1 dhe 2 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së. Veç kësaj, Gjykata e Qarkut shfajësoi N.G. dhe H.G. nga kryerja e veprës penale Krim i Organizuar siç përshkruhet në Pikat 1 deri 3 dhe siç përcaktohet me nenin 274 paragrafin 3 të KPPK-së dhe nenin 2.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/22.

7. Si të pandehurit ashtu edhe Prokurori Publik paraqitën ankesat e tyre me kohë në Gjykatën Supreme të Kosovës e cila mbajti seancën e saj më 30 qershor 2009 dhe, pas këshillimit të mbajtur të njëjtën ditë dhe më 2 korrik 2009 lëshoi Aktgjykimin Ap. – Kz. Nr. 394/2007.

Gjykata Supreme e Kosovës në Aktgjykimin e saj pjesërisht pranoi ankesën e Prokurorit Publik të paraqitur në dëm të të pandehurve, pjesërisht pranoi ankesën e paraqitur në dobi të N.G. dhe refuzoi ankesën e paraqitur në dobi të H.G. dhe rrjedhimisht ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut duke:

- ndryshuar cilësimin juridik të veprave penale për të cilat N.G. ishte shpallur fajtor nga Gjykata e Qarkut (Pika 1 u bë Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve në kundërshtim të nenit 245 paragrafit 2 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, KPRSFJ-së, Pika 2 u bë Blerja, posedimi,

shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, në kundërshtim të nenit 229 paragrafit 3 të Kodit Penal të Kosovës, Pika 3 nën pika (vii) u bë Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve në kundërshtim të nenit 245 paragrafit 2 të KPRSFJ-së;

- ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale për të cilën H.G. ishte shpallur fajtor nga Gjykata e Qarkut (Pika 2 u bë Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, në kundërshtim të nenit 229 paragrafit 3 të Kodit Penal të Kosovës);

- shfajësuar N.G. nga kryerja e gjashtë veprave penale Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve në kundërshtim të nenit 245 paragrafit 1 dhe 2 të KPRSFJ-së lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së siç përshkruhet në Pikën 3 nën-pikat (i)-(vi) të Aktgjykimit;

- shpallur N.G. dhe H.G. fajtor për kryerje të veprës penale Krim i Organizuar siç përshkruhet në Pikat 1 deri 3 në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 2 (sa i përket H.G.) dhe paragrafit 3 (sa i përket N.G.) të KPPK-së;

- dhe duke vërtetuar pjesën mbetur të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.

8. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 2 korrik 2009 i është dorëzuar Prokurorit Publik më 31 korrik 2009.

9. Prokurori i Shtetit i Kosovës ka paraqitur një Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë në dëm të N.G. dhe H.G. më 9 mars 2009.

Prokurori i Shtetit i Kosovës ka paraqitur një plotësim të kërkesës së tij më 11 mars 2010.

10. Avokatët mbrojtës dorëzuan përgjigjet e tyre, të datuara 17 mars dhe 18 mars 2010, në dobi të të pandehurve.

11. Gjykata Supreme mbajti seancën e saj më 25 maj 2010.

## II

Lejueshmëria e Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë.

12. Siç është parë më herët, aktgjykimi i Gjykatës Supreme është dërguar në Zyrën e Prokurorit të Shtetit më 31 korrik 2009 dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte paraqitur në këtë Zyre më 9 mars 2010.

Avokatët e të dy të pandehurve sipas mendimit të tyre e konsiderojnë kërkesën e Prokurorit për mbrojtje të ligjshmërisë si të paafatshme dhe i propozojnë Gjykatës ta hedhë poshtë atë sepse ishte paraqitur pas afatit tremujor nga dita e dorëzimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë në ZPShK, siç parashihet me nenin 452 paragrafin 3 të KPPK-së.

13. Në plotësimin e kërkesës së tij për mbrojtje të ligjshmërisë Prokurori i Shtetit, gjersa i referohet jurisprudencës së Gjykatës Supreme të Kosovës, pohon se Prokurori Publik

nuk është i kufizuar në afatin kohor prej tre muajve siç parasheh neni 452 paragrafi 3 i KPPK-së. Prokurori i Shtetit deklaroi se, sipas nenit 457 paragrafi 2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur në dëm të të pandehurit nuk do të ketë ndikim praktik negativ në asnjë të drejtë individuale madje dhe nëse kërkesa është e suksesshme por vetëm sistemi ligjor do të përfitonte. Përveç kësaj Prokurori i Shtetit pohon se interpretimi ndryshe i nenit 452 të KPPK-së mund edhe të ketë ndikim negativ në të drejtat e personit të dënuar në rastet kur Prokurori dëshiron të paraqesë kërkesë në dobi të atij personi.

14. Kjo Gjykatë është e mendimit se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e shqyrtuar këtu është e lejueshme sepse në Kodin e Procedurës nuk parashihet asnjë afat kohor për paraqitjen e kësaj këshille të jashtëzakonshme juridike nga Prokurori.

Dispozita relevante është neni 452 i KPPK-së, paragrafi i parë i së cilës parasheh mundësinë e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë për të dyja palët: Prokurorin Publik të Kosovës dhe të pandehurin apo avokatin e tij mbrojtës.

Paragrafi i njëjtë i siguron të pandehurit me një tjetër mbrojtje: **pas vdekjes së të pandehurit kërkesë në emër të tij** mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 443 paragrafi 1, fjalia e fundit e këtij kodi<sup>1</sup>.

Paragrafi i dytë i nenin 452 tregon se Prokurori Publik i Kosovës mund të paraqesë këtë këshillë të jashtëzakonshme juridike “në dëm dhe në dobi të të pandehurit”.

Paragrafi tretë përcakton afatin, **brenda tre muajve nga dita kur të pandehurit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i formës së prerë**.

Ky paragraf specifikon, megjithatë, se ky afat parashihet për “të pandehurin dhe avokatin e tij/saj mbrojtës dhe personat e paraparë në nenin 443 paragrafi 1, fjalia e fundit e këtij Kodi”.

Nga dispozitat ligjore të përmendura më lart mund të përfundohet se afati kohor prej tre muajve parashihet me Kodin e Procedurës Penale vetëm për të pandehurin, avokatin e tij mbrojtës dhe personat që veprojnë në emër të tij në rast të vdekjes së tij, por jo për Prokurorin Publik i cili vepron në interes të sistemit ligjor.

Kjo është e qartë duke krahasuar paragrafin 3 ku parashihet afati kohor për të pandehurin, avokatin e tij mbrojtës dhe personat të cilët veprojnë **në emër të të pandehurit pas vdekjes së tij** me paragrafin 2 ku për aktivitetin e Prokurorit Publik nuk ka asnjë afat kohor.

Po ashtu edhe dispozita sipas së cilës afati kohor fillon prej momentit kur **të pandehurit i dorëzohet vendimi gjyqësor i formës së prerë** (paragrafi 3) vërteton interpretimin e propozuar.

Në fakt, mundësia që Prokurori të marrë vendimin e formës së prerë **pas** të pandehurit mund të rezultojë me një kufizim të paarsyeshëm të së drejtës së tij për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

---

<sup>1</sup> Neni 443 i dedikohet këshillës së jashtëzakonshme juridike të rishikimit të procedurës penale dhe paragrafi i pari i këtij neni parasheh personat që mund të kërkojnë këtë këshillë juridike (palët dhe avokati mbrojtës). Fjalia e fundit e nenit 443 paragrafi 1 parasheh se “**Pas vdekjes së të dënuarit**, rishikimin mund ta kërkojë prokurori publik, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, farefisi në vijë direkt deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit”.

Interpretimi i propozuar gjen një precedent të rëndësishëm në Ligjin e Procedurës Penale të Jugosllavisë dispozitat e të cilit (neni 416 dhe nenet pasuese) i mundësuan vetëm “prokurorit publik kompetent” të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pa asnjë afat.

Shpjegimi i arsyeshëm për mungesën e ndonjë afati për Prokurorin Publik është treguar saktësisht në plotësimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga ZPShK-ja më 11 mars 2010.

Kërkesa e Prokurorit Publik mund të paraqitet në dëm dhe në dobi të të pandehurit, duke mos dëmtuar të drejtat njerëzore të këtij të fundit, ose në dëm të të njëjtit por në teorinë e fundit nuk mund të ketë ndikim në aktgjykimin e kundërshtuar që paragjykon vetë të pandehurin<sup>2</sup>.

Me fjalë tjera, kurdo që paraqitet në dëm të të pandehurit (neni 452 paragrafi 2 i KPPK-së) kërkesa e Prokurorit Publik për mbrojtje të ligjshmërisë rezulton vetvetiu me këshillë juridike në dobi të sistemit ligjor.

Është brenda kompetencave themelore të Prokurorit Publik të veprjë përherë në dobi të ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore.

Vendimi i gabuar gjyqësor paraqet precedent që në të ardhmen mund të dëmtojë aktgjykimet e reja.

Kjo shpjegon se interesi i sistemit ligjor është të mënjanoen vendimet e gabuara kurdoherë.

Gjykata vërteton se mund të ngrihet pyetja se a është interpretimi i dhënë në përputhje të plotë me kërkesat e një *gjykimi të drejtë* siç parashihet me nenin 5 të KPPK-së dhe, veçanërisht, me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Këtu vijnë në dëshmi parimet e vonesës së arsyeshme dhe parimi i *barazisë së armëve* në mes palëve në procedurë penale.

Sa i përket vonesës së arsyeshme mund të pohohet se mungesa e një afati për Prokurorin mund ta ekspozojë të pandehurin ndaj rrezikut të një procedure të pafund.

Mirëpo ky fakt praktikisht nuk ka pasoja për të pandehurin sepse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori në dëm të të pandehurit nuk mund të ndërhyjë në vendimin e formës së prerë dhe prandaj nuk mund të ketë ndikim negativ në të drejtat e tij njerëzore.

Përveç kësaj kjo është një këshillë e jashtëzakonshme juridike që mund të paraqitet kundër një vendimi që tanimë është i “formës së prerë” dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>3</sup> pranon se koha he procedurës që duhet ti përmbush kërkesat e arsyeshmërisë zgjat deri sa vendimi të bëhet i formës së prerë.

Thënë në përgjithësi, parimi i *barazisë së armëve* në mes palëve lë të kuptohet se periodat e njëjta ligjore të përshkruara kohore duhet të vlejné për të gjitha palët.

Megjithatë, natyra e kësaj këshillë të jashtëzakonshme juridike e paraqitur nga Prokurori Publik si këshillë juridike për mbrojtjen e ligjshmërisë së sistemit pa ndikuar në

---

<sup>2</sup> Neni 457 paragrafi 2 i KPPK-së thotë se: “kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të pandehurit është e bazuar mirë, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë”.

<sup>3</sup> Shih p.sh. GjEDNJ në lëndën Yagci dhe Sargin kundër Turqisë, Aktgjykimi 8 qershor 1995, Seria A, Nr. 319-A, paragrafi 58.

vendimin e formës së prerë duket se arsyeton heqjen e atij parimi pa cenuar të drejtat njerëzore të të pandehurit.

### III

Çështjet e ngritura në kërkesën e Prokurorit të Shtetit

15. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shtetit i Kosovës përmban këto pohime lidhur me shkeljen e ligjit:

- a. shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale – neni 403, paragrafi 1, pika 12 e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK);
- b. shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale që ndikuan në lëshimin e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë – neni 391 paragrafi 1 pika 3 i kombinuar me nenin 403 paragrafi 2 pika 1 KPPK;
- c. shkelje të ligjit penal veçanërisht të nenit 274 paragrafi 3 i Kodit Penal të Kosovës (KPK);
- d. shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale që ndikuan në lëshimin e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë – neni 396 paragrafi 5 KPPK i kombinuar me nenin 403 paragrafi 2 pika 1 KPPK.

Secila pikë do të shqyrtohet dhe vendoset si në vijim.

16. Në pikën e parë të kësaj kërkesë Prokurori i Shtetit pretendon në shkelje të nenit 403, paragrafit 1, pika 12 e KPPK-së sepse dispozitivi i Aktgjykimit të ankimuar është “i pakuftueshëm ose i paqëndrueshëm në brendi” dhe “aktgjykimit i mungon baza” në pjesën lidhur me shfajësimin e të pandehurit N.G. nga vepra penale Prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve sipas nenit 245 paragrafit 1 dhe 2 lidhur me nenin 22 të KP të RSFJ-së të përfshirë në nën-pikat prej (i) deri në (vi) të Pikës 3 të aktgjykimit të shkallës së parë.

Prokurori i Shtetit sjell ndër mend se në Aktgjykimin e kundërshtuar Gjykata Supreme konstatoi se nën-pikat e lartpërmendura (i) deri (vi) të Pikës 3 ishin të paqarta dhe nuk eliminuan dyshimet sa i përket përshkrimit të kohës, elementeve materiale të veprës penale dhe rrethanave në të cilat këto vepra penale ishin kryer.

Prokurori i Shtetit përkundrazi mbron pohimin se Aktgjykimi i shkallës së parë përmban shenja të qarta të veprave penale për të cilat i pandehuri ishte shpallur fajtor dhe se të gjitha gjashtë pikat e lartpërmendura treguan rolin e të pandehurit, sjelljen e tij fizike dhe dashjen e tij subjektive.

Përveç kësaj Prokurori i Shtetit pohon se në aktgjykimin e kundërshtuar Gjykata Supreme nuk ka dhënë asnjë bazë për vendimin e saj dhe “nuk ka shtjelluar drejt përkritazi me atë se cili është, “kriteri minimal për saktësi dhe qartësi” i supozuar, që gjykata e shkallës së parë është dashur ta zbatojë në dispozitivin e saj”.

17. Kjo pikë e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shtetit nuk është e bazuar.

Siç është përmendur tanimë në aktgjykimet e mëhershme të Gjykatës Supreme<sup>4</sup>, sipas leximit të kombinuar të nenit 396, par. 4 dhe nenit 391, par. 1 të KPPK-së, në rast të dënimit, dispozitivi duhet patjetër të përmbajë si “të dhëna të nevojshme”, mes tjerash, veprën për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor së bashku me faktet dhe rrethanat që tregojnë natyrën penale të veprës së kryer si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal.

Dispozitivi edhe pse është pjesë sintetike pa dyshim është pjesa themelore e aktgjykimit që do të thotë se elementet e sipërpërmendura duhet patjetër të shprehen në mënyrë shumë të qartë dhe të përjashtojnë çdo dyshim ashtu që i pandehuri dhe të gjithë të interesuarit të mund të kuptojnë akuzën për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor.

Është e drejtë themelore e çdo të pandehuri që t’i mundësohet ta kuptojë akuzën dhe aktgjykimin e marrë kundër tij. Dispozitivi i shpreh këto elemente në mënyrë sintetike, sepse me ligj (neni 396, par. 6 dhe 7 të KPPK-së) përcaktohet që pjesa e arsytimit (deklarimi i arsyeve) “të tregojë qartë dhe në hollësi se cilat fakte konsiderohen të dëshmuara apo të padëshmuara si dhe arsyet për një gjë të tillë”.

Natyrisht, në kuadër të elementeve të sipërpërmendura faktike, roli i të pandehurit, sjellja e tij materiale dhe qëllimi i tij subjektiv duket të jenë të rëndësishme themelore, siç është konstatuar me të drejtë nga Prokurori i Shtetit.

Varet nga Gjykata më e lartë, megjithatë, të vlerësojë nëse përshkrimi i këtyre elementeve të cilat i përmban dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar, është përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme apo jo.

Në këtë rast, së pari mund të vërejmë, në kundërshtim me pretendimin e Prokurorit të Shtetit, se aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Supreme përmban indikacionin e arsyeve për të cilat N.G. është shfajësuar nga akuzat e përfshira nga nënpikat (i) deri në (vi) të Pikës 3.

Gjykata e shkallës së dytë (faqe 3) sqaron kriteret të cilat shpjen në vendimin e saj duke na përkujtuar se pikat dhe cilësimi juridik i krimeve “duhet të jenë precizë dhe të qartë sa i përket kohës, elementeve materiale të krimin dhe rrethanave në të cilat janë kryer këto krime” dhe kjo me qëllim që t’i mundësojë gjykatës që t’i kuptojë faktet ndërsa të pandehurit që të jetë në gjendje të mbrohet në mënyrë të përshtatshme dhe të duhur.

Sipas këtyre parimeve, Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se mungojnë kriteret minimale të saktësisë dhe të qartësisë në ato gjashtë nënpikat, prandaj ka shfajësuar të pandehurin “për shkak të paqartësisë dhe dyshimeve” të ngritura në këto akuza.

---

<sup>4</sup> Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 21 korrik 2009 Ap-Kz 481/2008 O. Zyberaj dhe S. Shala.

Për shkak të këtyre kriterëve, vlerësimi i bërë nga Gjykata e shkallës së dytë rreth përcaktimit të gjashtë nënpikave nga (i) deri në (vi) të Pikës 3, nuk duket të përmbajë ndonjë gabim juridik apo logjik.

Koha, elementet materiale (siç është p.sh. sasia e drogës, itinerari dhe destinacioni i transportit) dhe rrethanat e kryerjes së veprës së ngarkuar penale duhet të shkoqiten në dispozitiv në mënyrë shumë të qartë.

Përndryshe, i pandehuri nuk do të ketë mundësinë që ta mbrojë veten, ndërsa Gjykata (e shkallës së dytë) nuk do të jetë në gjendje që ta vlerësojë si duhet seriozitetin e këtij krimi (që p.sh. lidhet me sasinë e drogës së transportuar, nga e cila pastaj ka mundësi të konstatohet nëse ajo drogë ishte e destinuar për shitje apo jo).

Nga teksti i dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë (Gjykata e Qarkut të Prishtinës më datën 27 prill 2007), del se këto gjashtë nënpika nuk janë përcaktuar dhe nuk janë saktësuar si duhet.

Pika 3, nënpika (i) na jep të kuptojmë se ngjarja ka ndodhur në muajin **qershor** 2003 dhe ka qenë e lidhur me transportimin e një sasive të **papërcaktuar** të heroinës nga Kosova në Itali.

Kjo nënpikë duket të jetë e përgjithësuar sepse nuk janë specifikuar sa duhet tri elemente faktike: koha duke na lënë që të kuptojmë se bëhet fjalë për një periudhë të gjatë sikur të ishte një muaj i plotë, sasia e drogës si dhe destinacioni i fundit i këtij transporti, sepse Italia është një vend shumë i madh dhe nuk është njësoj për të pandehurin kur ai mbron veten ndaj një akuze për transportim të drogës në një vend apo në një vend tjetër.

E njëjta gjë përkitazi me **sasinë e papërcaktuar** të heroinës dhe **destinacionin** e papërcaktuar përfundimtar (në Itali) vlen edhe Pikën 3, nënpikat [ii] dhe [iii], ku faktori **kohë** është akoma më i papërcaktuar (qershor – korrik 2003, nënpika [ii] dhe në mes muajve qershor dhe gusht 2003, nënpika [iii]).

Pika 3, nënpika [iv] mbetet e **papërcaktuar** përkitazi me **kohën** (periudha në mes të 9 dhe 15 shtator 2003) dhe përkitazi me **destinacionin** e transportit (Italia).

Pika 3, nënpikat [v] dhe [vi] mbeten të **papërcaktuara** përkitazi me **kohën** e kryerjes, sepse të dyja i referohen muajit **shtator** 2003.

Të gjitha elementet e sipërpërmendura faktike duken të jenë të paqarta dhe të papërcaktuara ngase përmbajnë një dozë të dykuptimësisë, duke ia pamundësuar të pandehurit ofrimin e sqarimeve të ndryshme, p.sh. alibinë.

As pjesa tjetër e aktgjykimit nuk rezulton të ketë elemente të mjaftueshme të nevojshme. Nga pjesa e arsytimit të aktgjykimit faktet e ngarkuara nuk janë të specifikuara më mirë, në përjashtim të destinacionit të transportit, të treguar me qytetet Brescia – nënpika (i) -,

Verona – nënpika (ii) -, Pisa – nënpika (iii) -, Padova – nënpika (iv) – dhe Milano – nënpikat (v) dhe (vi).

Elementet e tjera faktike, siç përmenden më sipër, megjithatë mbeten të papërcaktuara dhe kjo gjë nuk mundëson përmbushjen e kushteve të parapara me kodin procedural. Për më tepër, nga shkresat e lëndës dhe nga aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parës del se hetimet kundër të pandehurve dhe grupit të tyre lidhur me dërgesat e drogës kishin nisur në muajin nëntor 2003, që d.m.th. pas kryerjes së krimeve të përmendura në Pikën 3.

Është gjithashtu e qartë se hetimet lidhur me faktet e përmendura në Pikën 3, nënpikat [i] - [vi], të kryera në mes të muajit qershor dhe tetor 2003, janë bazuar në deklaratat (e dhëna nga C. për Pikën 3, nënpika [i], nga P. për Pikën 3, nënpikat [ii] - [vi], nga V. dhe nga C.K. për Pikën 3, nënpika [iv] dhe nga M. për Pikën 3, nënpikat [v] dhe [vi]) pa ndonjë dëshmi tjetër vërtetuese siç është p.sh. vëzhgimi i drejtpërdrejtë nga policia apo sekuestrimi i drogës.

Kjo gjë do të thotë se akuzat, të cilat mbështeten vetëm mbi kujtesën e dëshmitarëve, nuk mund të provohen dhe të bëhen më të qarta për të pandehurin përmes dëshmimeve të ndryshme. Kështu, mungesa e qartësisë në këto akuza, që vërehet nga aktgjykimi i kundërshtuar, nuk mund të zgjidhet përmes dokumentacionit të shkresave të lëndës.

18. Pika e dytë dhe e tretë e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë janë pikërisht të lidhura njëra me tjetrën, prandaj mund të trajtohen bashkazi.

Me pikën e dytë, Prokurori i Shtetit pretendon shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale (sipas leximit të kombinuar të nenit 391, par. 1, pika 3 me nenin 403, par. 2, pika 1 të KPPK-së), sepse Gjykata e shkallës së dytë – përkundër shpalljes fajtorë të të pandehurve N.G. dhe H.G. për veprën penale Krim i organizuar (siç përshkruhet në pikat 1, 2 dhe 3, nënpika (vii)) – nuk i ka rritur dënimet e tyre për shkak të siç pohohet mungesës së ankesës së Prokurorit publik mbi dënimin si të tillë.

Me pikën e tretë, Prokurori i Shtetit pohon se Aktgjykimi i ankimuar ka qenë në kundërshtim me ligjin penal sepse Gjykata Supreme nuk e ka dënuar N.G. edhe me gjobë siç përcaktohet për veprën Krim i organizuar në nenin 274, par. 3 i KPPK-së.

Prokurori i Shtetit përkujton se në aktgjykimin e kundërshtuar, Gjykata Supreme ka konstatuar se edhe pse të pandehurit ishin shpallur fajtorë edhe për Pikën e Krimin të organizuar, dënimi i tyre nuk ka mundur të rritet “për shkak të mungesës së ankesës së Prokurorit lidhur me dënimin si të tillë” (faqja 5 e Aktgjykimit në anglisht).

Prokurori i shtetit kundërshton këtë konstatim duke argumentuar se ankesa e Prokurorit publik të qarkut, e paraqitur kundër shfajësimit të gjykatës së shkallës së parë për akuzën Krim i organizuar, ka përmbajtur pa dyshim kërkesën për dënimin e të pandehurve në përputhje me ligjin.

Në këtë rast, ankesa e Prokurorit publik nuk ka qenë një ankesë e thjeshtë mbi dënimin e shqiptuar, por në të vërtetë një ankesë për shkeljen e ligjit penal.

19. Kjo pikë e ankesës është e bazuar. Sipas nenit 415, par. 1 të KPPK-së, shtrirja e shqyrtimit ankimor është e përcaktuar me ankesë, në këtë rast të Prokurorit publik.

Në ankesën e saj, të datës 10 qershor 2007 për lëndën PP Nr. 348-4/05, Prokurori publik kundërshton Aktgjykimin për shkak të shkeljes esenciale të ligjit penal lidhur me shfajësimin e të pandehurve nga akuza e Krimin të organizuar për të gjitha pikat, dhe për shkak të arsyeve të paraqitura në ankesë, prokuroria propozon që të pandehurit të shpallen fajtor për Krim të organizuar sipas pikave përkatëse të Aktakuzës së ndryshuar.

Shtrohet pyetja nëse Prokurori publik në ankesën e saj ka përfshirë propozimin për rritjen e dënimeve, edhe pse kjo gjë nuk është shprehur në mënyrë të qartë në tekstin e ankesës. Me fjalë të tjera, nëse vendimin i Gjykatës së Qarkut mbi dënimin ka qenë brenda kufijve të shqyrtimit ankimor të gjykatës së shkallës së dytë në bazë të ankesës së Prokurorit publik.

Parimet e përgjithshme të Kodit Penal të Kosovës (KPK) nuk lejojnë asnjë dyshim mbi faktet që sipas ligjit secila vepër penale duhet patjetër ta ketë dënimin përkatës. Neni 6 i KPK-së përkufizon veprën penale si një veprim të jashtëligjshëm karakteristikat e së cilës janë të përkufizuara me ligj dhe “për të cilën ligji përcakton sanksionin penal”.

Neni 71 i KPK-së përcakton që aktvendimi në rastet kur kryerësi kryen disa vepra penale përkufizon që “gjykata së pari shqipton dënimin për secilën vepër dhe pastaj shqipton dënimin unik për të gjitha këto vepra”. Është e qartë se sipas kodit penal, për çdo vepër penale përcaktohet dënimi përkatës.

Në rast të shumë veprave penale, gjykata në fund bashkon dënimet e ndryshme të shqiptuara në momentin e parë për **secilin** krim. Mund të shtojmë se në bazë të nenit 379 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) në fund të shqyrtimit gjyqësor, në fjalën e tij përfundimtare Prokurori i paraqet propozimet e veta lidhur me përgjegjësinë penale të të pandehurit por ai nuk ka të drejtë (“nuk mund”) të propozojë kohëzgjatjen e dënimit.

Nga ky sistem, prandaj, dalin dy parime: 1. Çdo vepër penale ka si pasojë ligjore sanksionimin, 2. dënimi del drejtpërdrejt nga ligji dhe zbatohet nga gjykata pa asnjë propozim të Prokurorit.

Në shkallën e parë, kërkesa e Prokurorit për shpalljen e të pandehurit fajtor për veprën penale, përmban qartë kërkesën për shqiptimin e dënimit të përcaktuar me ligj kundër tij.

Këto dy parime janë parime të vlefshme prandaj duhet të zbatohen jo vetëm në shkallën e parë por gjithashtu edhe gjatë gjykimit të shkallës së dytë.

Ajo çfarë është vërejtur lidhur me këtë pikë nga aktgjykimi i kundërshtuar, d.m.th. mungesa e ankesës së Prokurorit lidhur me dënimin si të tillë, nuk mund të konsiderohet si e saktë.

Kjo ngase Prokurori ka paraqitur ankesë që të dy të pandehurit të shpallen fajtorë për Krim të organizuar në përputhje me nenin 274 të KPK-së dhe se kjo ankesë pa dyshim përfshin edhe kërkesën për ndëshkimin ligjor për këtë krim.

Arsyet janë, siç u tha më lart, që çdo vepër penale ka për pasojë ligjore sanksionimin e saj juridik dhe se Prokurori nuk ka të drejtë që të propozojë kohëzgjatjen e këtij dënimi.

Prandaj, fakti që ankesa e Prokurorit nuk përmban një kërkesë të qartë për zbatimin e dënimit të caktuar për veprën penale të krimit të organizuar, nuk e dobëson natyrën e ankesës së tij, e cila synon që të sigurojë deklarin e përgjegjësisë penale dhe pasojat e këtij deklarimi, ashtu siç përcaktohet me ligj – që d.m.th. dënimin e të pandehurit të shpallur fajtor.

Për më tepër, në këtë rast nuk mund të zbatohet ndalesa e përcaktuar me nenin 417 të KPPK-së – për ndryshimin e aktgjykimit në dëm të të pandehurit kur në favor të tij paraqitet vetëm një ankesë, sepse Prokurori ka paraqitur me kohë ankesën në dëm të të pandehurit.

Gjykata e shkallës së dytë nuk ka zbatuar nenet 6, 71 dhe 274, par. 2 dhe 3 të KPK-së dhe nenin 391, par. 1, pikën 3 të KPPK-së dhe ky lëshim ka pasur ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të duhur (neni 403, par. 2, pika 1 e KPPK-së).

20. Konstatimi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 2 korrik 2009 Ap.-Kz. Nr. 394/2007 përmban shkelje të ligjit, të neneve 7 dhe 71 të KPK-së, sepse nuk ka zbatuar ndëshkimin ligjor të të pandehurve N.G. dhe H.G. për veprat penale të a) krimit të organizuar, sipas nenit 274, par. (3)<sup>5</sup> siç përshkruhet në Pikat 1, 2 dhe 3 (vii) të aktgjykimit dhe b) të krimit të organizuar sipas nenit 274, par. (2)<sup>6</sup> siç përshkruhet në Pikën 2 të aktgjykimit.

Përveç dispozitave ligjore të kodit penal të përmendura më lart, është shkelur edhe neni 391, par. 1, pika 2 dhe neni 403, par. 2, pika 1 e KPPK-së. Kjo shkelje ndikon gjithashtu edhe në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të datës 27 prill 2007, P. Nr. 740/2005, me të cilin është i lidhur fort edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë.

21. Në pikën e katërt, Prokurori i Shtetit pretendon se ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale (sipas leximit të kombinuar të nenit 396, par. 5 me nenin 403, par. 2, pika 1 e KPPK-së), sepse Gjykata Supreme e Kosovës, përkundër dënimit të të dy të pandehurve për Krim të organizuar dhe të shfajësimit të N.G. për gjashtë nënpikat e Pikës 3 të Aktgjykimit të shkallës së parë, nuk ka bërë të qartë në dispozitiv as dënimin e përcaktuar për secilën vepër penale, as dënimin unik.

<sup>5</sup> I cili përcakton dënimin me gjobë deri në 500.000 EURO si dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

<sup>6</sup> I cili përcakton dënimin me së paku pesë vjet burgim.

Sipas Prokurorit të shtetit, Gjykata Supreme është dashur që të “tregojë dënimin për Krim të organizuar, është dashur që të rillogaritë dënimin për Pikën 3 dhe është dashur që të specifikojë dënimin unik të zbatuar” dhe “një llogaritje e drejtë e dënimit me siguri se do të shpinte tek një dënim më të ashpër të të pandehurve”.

22. Kjo pikë e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nuk ka bazë. Gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë dhe ka konstatuar vërtetimin e pjesës tjetër të tij.

Ndryshimet që vlejné të përmenden këtu kanë të bëjnë me dënimin e të pandehurve për krim të organizuar për të cilin ata ishin shfajësuar në shkallën e parë dhe me shfajësimin e N.G. për gjashtë nënpikat (i) - (vi) e Pikës 3.

Ndryshimi i parë (dënimi i të pandehurve për krimin e organizuar) vërtet është dashur të kalojë gjykatën e shkallës së dytë për shqiptimin edhe të një dënimi tjetër. Një gjë e tillë nuk është bërë dhe kjo paraqet shkelje të ligjit penal dhe shkelje esenciale të procedurës penale të përmendur tashmë në paragrafët e mësipërm 18 – 20.

Shkelja tjetër e nenit 396, par. 5 të KPPK-së, e ngritur nga Prokurori i shtetit lidhur me këtë pjesë të aktgjyimit të Gjykatës së shkallës së dytë megjithatë konsumohet me shkeljen esenciale të procedurës penale të treguar më lart (neni 391, par. 1, pika 3 dhe neni 403, par. 2, pika 1 e KPPK-së), prandaj nuk ka nevojë për deklarimin e posaçëm të tij.

Sa i përket pjesës për të cilën Gjykata e shkallës së dytë kishte shfajësuar N.G. nga gjashtë nënpikat (i) - (vi) të Pikës 3, kjo gjykatë është e mendimit se aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban asnjë shkelje esenciale të procedurës penale.

Aktgjykimi i shkallës së parë ka dënuar N.G. si më poshtë:

- Pika 1 burgim në kohëzgjatje prej 7 vjetësh,
- Pika 2 burgim në kohëzgjatje prej 5 vjetësh.

Sa i përket Pikës 3, aktgjykimi i parë ka përcaktuar këto dënime për secilën nënpikë:

- Pika 3 nënpika (i) burgim në kohëzgjatje prej 3 vjetësh,
- Pika 3 nënpika (ii) burgim në kohëzgjatje prej 3 vjetësh,
- Pika 3 nënpika (iii) burgim në kohëzgjatje prej 3 vjetësh,
- Pika 3 nënpika (iv) burgim në kohëzgjatje prej 7 vjetësh,
- Pika 3 nënpika (v) burgim në kohëzgjatje prej 5 vjetësh,
- Pika 3 nënpika (vi) burgim në kohëzgjatje prej 5 vjetësh,
- Pika 3 nënpika (vii) burgim në kohëzgjatje prej 5 vjetësh.

Gjykata e shkallës së parë pastaj ka bashkuar dënimet për të gjitha nënpikat e Pikës 3 në burgim në kohëzgjatje prej 12 vjetësh.

Përfundimisht dënimet e ndryshme për secilën Pikë janë bashkuar në një burgim në kohëzgjatje prej 15 vjetësh.

Gjykata e shkallës së dytë ka shfajësuar N.G. nga të gjashtë nënpikat e Pikës 3 dhe, përveç ndryshimeve tjera të cilat nuk janë të rëndësishme të përmenden këtu, ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në pjesën tjetër e cila përmban po ashtu edhe kohëzgjatjen e dënimeve të shqiptuara ndaj këtij të pandehuri.

Sa i përket kësaj pjese pretendimi i Prokurorit të shtetit nuk qëndron ngase aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban asnjë shkelje esenciale të procedurës penale.

Në fakt, shfajësimi i të pandehurit nga akuzat e dhëna në nënpikat (i) - (vi) qartë eliminon dënimet përkatëse dhe në përputhje me këtë e bën të panevojshëm bashkimin e parë të dënimeve të shqiptuara për të gjitha nënpikat e Pikës 3.

Ajo çfarë mbetet është dënimi me burg në kohëzgjatje prej 5 vjetësh tek nënpika (vii) e cila duhet patjetër që të bashkohet me dënimet e shqiptuara tek Pika 1 (prej 7 vjetësh) dhe Pika 2 (prej 5 vjetësh), në përputhje me Nenin 71, par. 1 dhe 2, pika 2 e KPPK-së.

Duke konfirmuar në këtë pikë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë ka konfirmuar dhe ka pranuar bashkimin përfundimtar të bërë nga shkalla e parë.

Madje edhe pas shfajësimit për nënpikat (i) - (vi), dënimet e shqiptuara dhe bashkimi i tyre nuk shkelin procedurën penale, sepse dënimi unik (prej 15 vjetësh) është më i lartë sesa secili dënim individual dhe më i ulët sesa shuma e tyre (prej 17 vjetësh).

Mbase do të kishte qenë më e qartë po qe se shkalla e dytë do ta kishte specifikuar arsyetimin e saj lidhur me bashkimin e dënimeve por një lëshim i këtillë nuk paraqet shkelje esenciale të procedurës penale sepse nuk ndikon në nxjerrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të duhur.

Për këto arsye është vendosur si në dispozitiv.

**Sot më 25 maj 2010**  
**Pkl.-Kzz. Nr. 26/2010**

Përgatitur në anglisht, si gjuhë e autorizuar.

**Kryetari i kolegjit**

Emilio Gatti

**Anëtari i kolegjit**

Gerrit-Marc Sprenger

**Anëtarja e kolegjit**

Emine Kaçiku

**Procesmbajtësi**

Sampsa Hakala

**Këshillë juridike**

Kundër këtij vendimi nuk mund të paraqitet më kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë (Neni 451, paragrafi 2 i KPPK-së).



**Anëtari i kolegjit**

Avdi Dinaj

**Anëtarja e kolegjit**

Emine Mustafa